

**Juljana KUME**

## **HAPËSIRA TË LIGJËRIMIT TË THJESHTË PËR KRIJIMIN E TOGFJALËSHAVE TË QËNDRUESHËM**

Zhvillimet e vullshme, fenomenet dhe problematikat e ndryshme të shoqërisë në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti janë shoqëruar me lindjen dhe zhvillimin e dukurive e veprimtarive të ndryshme njerëzore, të cilat gjatë ligjërimit si të thjeshtë në përditshmëri, po ashtu edhe në atë të specializuar, ndiejnë domosdoshmërinë e emërimit të një nocioni të ri ose rikuptimësimin e një dukurie të re socialo-teknike. Pikërisht një nga mënyrat e mjetet që karakterizohen nga veçori e veti të caktuara specifike janë togjet leksikore emërore të qëndrueshme, veçanërisht ato të përbëra nga *emër në rasën emërore të pashquar + emër në rasën rrjedhore të pashquar*, të cilat zakonisht emërtojnë një kuptim të ri ose rikuptimësim të një dukurie të re, ndryshe nga kuptimi i elementeve përbërëse, duke u bërë një nga mjetet kryesore në ligjërimitin e përgjithshëm në luftën për zëvendësimin e fjalëve dhe nocioneve të huaja vërshuese në shqipe. Ndryshe këto togje mund t'i përkufizojmë: *Njësi e veçantë emërtuese leksiko-sintaksore me vlerën e një pjese të ligjëratës ku mund të përdoren një grup fjalësh me lidhje të ngurosor kryesisht dygjymtyrëshe që shërbejnë në përdorimin ligjërimor për formimin e emrave, që shënojnë objekte, dukuri ose veti të tyre të konceptuara si të tilla të realitetit dhe që në ditët tona paraqitet si një mjet me efikasitet të lartë për krijimin me lehtësi të fjalëformave për plotësimin e nevojave të gjuhës në komunikimin e përgjithshëm.*

Mjafton të ndjekim shtypin e përditshëm, gazetat, revistat për të kuptuar rëndësinë e këtyre fjalëformave, si element thelbësor i politikave gjuhësore për kristalizim, njehsim, pasurim të gjuhës mbështetur në mundësitë e brendshme të vetë shqipes. Shembujt e këtyre togfjalëshave në ligjërimin e përgjithshëm janë të pafund, p.sh.: *leje qendrimi, leje kalimi, certifikatë lindje, orë dore, kostum martese, bojë flokësh, bar miu, shkollë muzike, kopësht fëmijësh, vend takimi, panxhar sheqeri, furçë dhëmbësh, materiale ndërtimi* etj. Si dhe në rastet kur një prej elementeve të togut është huazim i hershëm i shqipes (shpërfaqur sipas rrafshit diakronik dhe diatopik) nga gjuhët e huaja fqinje me përdorim në ligjërimin e thjeshtë dhe atë krahinor, p.sh.: togje të qëndrueshme (me figurshmëri): *shportë karavidhesh* (shportë gaforresh); *skile e vjetër* (dhelbër e vjetër); *kuvli zogu* (kafaz zogu) në shq. me ngjyresë negative etj. Togje të qëndrueshme (jo të figurshme): *pallamar kërpi* (litar çeliku) nga ven.; *pezul plehrash* vjet. (grumbull plehrash); *patomë dheu* vjet. (dysHEME dheu); *lakër arme* krahin. (lakër turshi); *gur sinori* vjet. (gur kufiri); *dele cangadhe* (dele që ka mbetur pa qengj e që mbahet për qumështetj.); *dërmon gruri* krahin. (shoshë); *gastare ujë* (gotë ujë); *rrush korith; cipura rrushi* (bërsi rrushi); *aplladhe bakri* krahin. (enë / pjatë bakri) etj.<sup>1</sup>

Detyrat që na dalin në këtë punim janë:

a. ndjekja e metodës pasqyuese e studimeve rreth togfjalëshave të qëndrueshëm / frazeotermave në gjuhësinë shqiptare;

b. analizimi i togfjalëshave të qëndrueshëm për të dhënë jo vetëm ndërtimin e tyre morfologjik dhe sintaksor,

c. por edhe marrëdhëniet e përbashkëta dhe dalluese të tyre me togfjalëshat e lirë; togjet e qëndrueshme terminologjike;

d. lokucionet, kompozitat etj.

Ndërkaq, evidentimi i togjeve të qëndrueshme të përdorura në tekstin e artikullit përkatës ndjek linjën e dendurisë së

---

<sup>1</sup> Vjelë nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980 dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954.

përdorimit në ligjërimitin e përgjithshëm / të thjeshtë dhe vjelja e tyre është bërë duke u mbështetur në shtypin e përditshëm / gazeta / revista. Për të kuptuar rëndësinë e këtyre fjalëformave në ligjërimitin e përditshëm mjafton të ballafaqohemi me vendin që këto fjalëforma zënë veçanërisht në FGJSSH e '80-ës, përkatësisht në mikrostrukturën e tij. Për evidentimin dhe dallimin e tipareve të këtyre togjeve të qëndrueshme (jofrazeologjikë) nga ata frazeologjikë në ndihmë na ka ardhur veçanërisht “Fjalori frazeologjik” dhe “Leksikologjia e gjuhës shqipe” e prof. J. Thomait, ku midis togjeve të qëndrueshme (frazeologjikë) me burim popullor folklorik kemi arritur të veçojmë togje, tipare që u përkasin grupimeve emërore të qëndrueshme (jofrazeologjike).

Në lidhje me shtjellimin e detyrave (objektivave) të sipërpërmendura, ky artikull do të prekë përmbledhtas disa prej tyre.

A. Më parë kjo dukuri gjuhësore nuk është vlerësuar sa duhet si pasuri e veçantë leksikore, që plotëson nevojat e komunikimit ndërmjet njerëzve, nevoja që vijnë në rritje gjatë ditëve të sotme. Pra, deri pak kohë më parë, dukuria e togjeve të ngurtësuar nuk ka qenë objekt studimi i mirëfilltë dhe i thelluar i gjuhëtarëve. Ato janë përmendur brenda familjes së madhe të frazeologjisë, por pa u ndalur në detajet e hollësishme që i dallon këto togje nga togfjalëshat në përgjithësi dhe ata të qëndrueshëm në veçanti (frazeologjikë nga jofrazeologjikë dhe këta nga ata terminologjikë), pa dalluar ngjyrimet kuptimore të veçanta apo emërtimet që u janë veshur, si dhe rëndësinë e dendurinë e lartë të përdorimit që kanë gjatë ligjërimit në jetën e përditshme etj.<sup>2</sup> Togjet e qëndrueshme burimin e kanë nga emërtimet e pathjeshta, që me kalimin e kohës janë ngurtësuar dhe kanë mbetur si të tilla në të gjitha fushat e jetës. A. Duro në studimet e tij i trajton gjerësisht ato nga këndvështrimi

---

<sup>2</sup> Këtë problematikë e trajton A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, “Studime mbi leksikun”, 2, 1972, f. 85, sipas të cilit: “Në çerdhet e fjalorit nuk janë futur shumë togje të qëndrueshme fjalësh që kanë një unitet organik kuptimi dhe përdoren gjerësisht si: aeroplan gjuajtës”.

terminologjik dhe quan emërtime të pathjeshta ato njësi të barasvlershme me togjet e qëndrueshme jofrazeologjike (përkatësisht në gjuhët speciale) si: *bombë dore*, *këpucë me qafë*; *bibliotekë kombëtare* etj.<sup>3</sup> Ndërkaq sipas prof. Duros dhe referuar përkufizimeve të dijetarëve të huaj termi frazeotermë<sup>4</sup> (frazë + term) përdoret për emërtimin e togjeve të qëndrueshme terminologjike. Studiuuesi M. Samara ka bërë një përjasje duke u përqendruar në karakteristikat e këtyre togjeve të qëndrueshme, por nuk i ka dhënë një emërtim të qëndrueshëm, herë i quan togfjalësha terminologjike p.sh.: *shportë karavidhesh (keq)* ~ “grup politik i paqëndrueshëm në bindjet e tyre” dhe herë i quan fjalë, terma dhe togfjalësha të rinj. Pra, ai dallon figurshmërinë, qëndrueshmërinë e elementeve përbërëse, por nuk i përcakton me termin e duhur.<sup>5</sup> Ndërkaq, S. Floqi i quan: togfjalësha të qëndrueshëm terminologjike; ndërsa A. Kostallari (1968) ka meritën e dallimit të lidhjeve (togjeve) të qëndrueshme me karakter terminologjik. Edhe prof. J. Thomai ka dalluar se në gjuhë kemi edhe togje të qëndrueshme jofrazeologjike dhe bën dallimin nga togfjalëshat emërorë të tipit frazeologjik, duke u ndalur dhe duke u thelluar në karakterin idiomatik, të figurshëm e frazeologjik të këtyre të

<sup>3</sup> A. Duro, “Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjike në gjuhën shqipe”, *Terminologjia si sistem* (Gjuhësi), Panteon 2001, f. 45-47.

<sup>4</sup> Referuar disertacionit të dr. Ciljeta Nikolla “Veçori të frazeotermave në ligjërimet publike të politikanëve shqiptarë dhe të huaj”, 2019, sipas së cilës (*Termi frazeoterm për herë të parë është përmendur në përkthimet franceze të studiuesit gjerman Franz Josef Hausmann në veprën “Lexicographie française et phraséologie. In: Hausmann”* (2007) mbi kolokacionet, ku ka arritur të dallojë disa emërtime të ndryshme nga kolokacionet që i quan frazeoterma dhe është i pari studiues që e ka emërtuar frazeotermën duke dhënë edhe karakteristikat e tij. Një ndër to ishte mosprezenca e foljes në këto ndërtime, gjë që e vërtetojmë edhe ne në studimet tona, frazeotermat nuk kanë për bazë folje).

<sup>5</sup> M. Samara, vëzhgimet në fjalor nga FGJSSH (1980 dhe FShS (1984/2002), f. 52.

fundit<sup>6</sup>. Këto togje nuk formohen në çastin e ligjërimit, por janë ndërtuar historikisht dhe janë bërë të pazbërthyeshme duke u përdorur si njësi të gatshme, njësoj si fjalët.<sup>7</sup> Gjuhëtarët si G. Vajgandi, A. Dozoni, si dhe K. Cipo, duke u nisur nga karakteri i qëndrueshëm i lidhjeve brenda njësisve të këtyre togfjalëshave, sidomos të tipit *emër në rasën emërore të pashquar + emër në rrjedhore* i kanë marrë ato për kompozita. G. Vaigandi si kompozim të mirëfilltë dhe më të rëndësishëm në shqipe quan pikërisht këtë tip togfjalëshi (*emër në emërore + emër në rrjedhore*), si p.sh.: *breg-det, bukë-thekre, shkëmb-guri* ...<sup>8</sup> etj. Gjithashtu, përdorimi i togjeve të ngurtësuara si mënyrë për formimin e fjalëve të reja në shqipe është cekur dhe më parë në disa artikuj të K. Cipos<sup>9</sup>, i cili, duke folur për kompozita determinative ndajshtimore, i trajton ato si “kompozita sui generis” duke theksuar praninë e tyre në shqipe. Këtë emërtim e risjell edhe prof. M. Domi në artikullin “Disa çështje të lokucioneve”<sup>10</sup>, ku në këtë kategori ka përfshirë çështjen e “kompozitës sui generis” referuar emërtimit që i ka bërë prof. Kostaq Cipo në *Gramatikën e tij* (1949, f. 48), sipas të cilit quan atë të formuar nga dy emra, “ku gjymtyra e dytë i shërben të parës si ndajshtim ose si atribut”, si *valle-nuse* “një valle e bukur si ajo e nuses”, nga të cilët i pari është në rasën emërore të pashquar dhe i dyti tregon prejardhje, lëndë, mënyrë etj., në rasën rrjedhore të pashquar në numrin njëjës dhe në numrin

---

<sup>6</sup> J. Thomai, “Njësia frazeologjike dhe togfjalëshi i lirë”, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 201.

<sup>7</sup> J. Thomai, “Njësia frazeologjike dhe togfjalëshi i lirë”, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 202. *Një togfjalësh i lirë kalon në njësi frazeologjike duke u përdorur vazhdimisht dhe duke u përsëritur për një kohë të gjatë jo me kuptimin e tij të drejtpërdrejt (në rrafshin e parë kuptimor), por me kuptim të figurshëm (në rrafshin e dytë kuptimor). ...*

<sup>8</sup> A. Duro, “Terminologjia si sistem” (Gjuhësi), *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, f. 46-47.

<sup>9</sup> K. Cipo, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, në dy vëllime, 1972 Vëllimi I, f. 63-64.

<sup>10</sup> M. Domi, “Disa çështje të lokucioneve”, *Studime filologjike*, nr. 1, 1985, f. 209-217.

shumës, si: *lule dhensh, ve pule, gur kufiri, zog pulash, lëng pule, bukë gruri* etj.<sup>11</sup> Për atë kohë, merita e këtij studiuesi ishte se ai vë re një mënyrë fjalëformimi të veçantë, si dhe, duke hasur vështirësi në trajtimin edhe emërtimin e tyre, i ka quajtur kompozita “sui generis”. Brenda kësaj kategorie ka përfshirë edhe ato pak emra të përngjitur që e kanë burimin nga togjet e qëndrueshme, por si pasojë e përdorimit të hershëm të ngurtësuar ka ndodhur procesi i ngjitjes së sintagmës p.sh.: *vajguri, punëdore, farefis* etj.<sup>12</sup> Studiuesi M. Samara, i cili është thelluar në togfjalëshat e qëndrueshëm në fushën e leksikut politiko-shoqëror, e konsideron këtë fushë si një nga fushat me terminologji më të pasur në gjuhën tonë dhe me interes studimi.<sup>13</sup> Këto togje të qëndrueshme emërore janë pasqyruar të cinguar në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 1954, por më vonë këta togfjalësha kanë zënë vendin e merituar në punimet

---

<sup>11</sup> Po ai, *po aty*, f. 216. *Po në shqip kemi edhe kategori të tjera togjesh emërore të qëndrueshme monolite nga kuptimi, që emërtojnë një send të vetëm dhe paraqesin një kohezion strukturor mjaft të dukshëm. Janë të formuar zakonisht prej një emri të pashquar dhe një emri tjetër në rrjedhoren e pashquar ose prej një emri të shquar dhe një emri tjetër në gjinore të shquar: “lule akulli” “lulja e akullit”. Me të tillë mënyrë janë formuar emërtimet e mjaft luleve e bimëve e të ndonjë sendi a nocioni tjetër: “lule blete”, “lule dimri”, “lule dhensh”, “bar ethesh”, “bar delli”, “gjel deti” etj.*

<sup>12</sup> Gjithashtu, ato pak emra të përngjitur që janë e kanë burimin nga togjet e qëndrueshme ku, për shkak të përdorimit të hershëm historik, ka ndodhur procesi i ngjitjes së sintagmës p.sh.: *farefis, bregdet, vajguri, luledielli, punëdore* etj., ndryshe nga pikëpamja apo argumentimi që i kanë bërë kësaj dukurie Weigandi dhe K. Cipo, duke i përfshirë në kategorinë e kompozitave, veçse me të vetmin ndryshim, K. Cipo, sikurse përmendëm më lart, duke hasur vështirësi në trajtimin e tyre, i ka quajtur kompozita “sui generis”.

Për më tepër: L. Buxheli, “Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe”, Kreu III, *Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës të formuara me përngjitje*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009.

<sup>13</sup> M. Samara, *Mbi leksikun politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas Çlirimit*, “Studime mbi leksikun”, 1, 1972, f. 281.

leksikografike, disertacione dhe fjalorë (referuar veçanërisht FGJSSH të '80-ës) etj. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980 është më i pasuri me këta togfjalësha, në krahasim edhe me fjalorët e tjerë vijues të shqipes (1984, 2002, 2006, 2020). Në FGJSSH '80 këta togfjalësha janë dhënë si mjete ilustruese, duke zgjeruar mikrostrukturën e fjalorit, por nuk mungojnë ato pak raste kur disa prej tyre janë përfshirë si njësi më vete. Ndërkaq, në “Gramatikën e gjuhës shqipe”<sup>14</sup> përcaktohen mënyrat kryesore të fjalëformimit të emrave, përkatësisht *prejardhja* dhe *kompozimi, konversioni* me anë të emëzimit (të pjesëve të tjera të ligjëratës, kryesisht të mbiemrave dhe pjesoreve) dhe rruga *semantike* ose formimi i fjalëve homonime. Në këtë renditje nuk përmendet një nga mënyrat po aq të rëndësishme të formimit të emrave, togfjalëshat e qëndrueshëm (zakonisht *emër rase emërore trajtë e pashquar + emër në rasën rrjedhore*), pasi në komunikimin e përditshëm ose në përpjekje për zëvendësimin e fjalëve dhe koncepteve të huaja, gjuha shqipe përdor mjete të tjera përveç atyre të përcaktuara në GGJSH. Po ashtu, kjo problematikë me analizimin e detajuar të togjeve të qëndrueshme është trajtuar gjerë e gjerë edhe nga studiuesja Ina Arapi (Vjenë)<sup>15</sup>.

## **B. Togjet e qëndrueshme jofrazeologjike**

**a.** Emër në rasën emërore, njëjës, të pashquar + emër në rasën rrjedhore të pashquar i ndeshim edhe me vendosje strukturore ndryshe

**b.** Kur gjymtyra e parë e togut është në të shquarën, elementi i dytë transformohet në rasën gjinore (shih edhe më sipër) sipas tipit: *lule blete* në *lulja e bletës*, *lule akulli* në *lulja e*

---

<sup>14</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.

<sup>15</sup> I. Arapi, *Togfjalëshat e qëndrueshëm si mënyrë për formimin e emrave në gjuhën shqipe në gjuhën shqipe*, [https://www.academia.edu/37965916/Togfjal%C3%ABshat\\_e\\_q%C3%ABndruesh%C3%ABm\\_si\\_m%C3%ABnyr%C3%ABp%C3%ABr\\_formimin\\_e\\_emrave\\_n%C3%ABgjuh%C3%ABn\\_shqipe](https://www.academia.edu/37965916/Togfjal%C3%ABshat_e_q%C3%ABndruesh%C3%ABm_si_m%C3%ABnyr%C3%ABp%C3%ABr_formimin_e_emrave_n%C3%ABgjuh%C3%ABn_shqipe)

*akullit* etj.<sup>16</sup>, edhe pse bëhet fjalë për të njëjtin togfjalësh, i cili është një nga mjetet kryesore në ditën e sotme për shprehjen e nocioneve të reja në shqip.

c. Të njëjtin togfjalësh e ndeshim të transformuar edhe me emër në rasën emërore e pashquar njëjës + parafjala *për* + rasa kallëzore e pashquar, veçanërisht kur gjymtyra e dytë shënon destinacion. Gjithashtu edhe këta togje me strukturë vendosjeje të tillë emërojnë nocione të reja që kanë hyrë në gjuhë, p.sh.: *ftesë për pjesëmarrje, kërkesë për leje; kostum për burra* etj.

d. Po ashtu, kur gjymtyra e dytë shënon lëndë prej së cilës është i përbërë sendi i gjymtyrës së parë dhe midis dy emrave përfshihet parafjala “prej”, p.sh.: *bluzë pambuku në bluzë prej pambuku; çantë lëkure në çantë prej lëkure* etj. (referuar GGjSh 2002).

e. Gjymtyrët përbërëse mund të jenë edhe **mbiemra të emëruar**<sup>17</sup> p.sh.: *e drejta e jetës; e mira e shtëpisë; e bukura e klasës; i kuqi i buzëve* etj., si dhe nga pjesët e tjera të ligjëratës.

f. Sigurisht që togjet e qëndrueshme përdoren edhe sipas strukturës emër + mbiemër, p.sh.: *kosh plehrash, koshtëri i vogël; skile e vjetër* “dhelqer e vjetër” me kuptimin të figurshëm - njeri në moshë shumë të zguar dhe i shkathët që nuk i shpëton asgjë, *njeri i djallëzuar*, si dhe si njësi të përngjitura me vlerë mbiemërore: *ngjyrëkafe, bojëgjështenje, ngjyrëvishje*, ose sintagma mbiemërore me lidhje bashkimi të tipit *mbiemër + lidhës bashkërenditëse + mbiemër: bardhezi < i bardhë e i zi; bardheblu < i bardhë e blu*<sup>18</sup> etj.

Për sa i përket vendit të gjymtyrëve të togut të qëndrueshëm, vëmë re se elementi i dytë i togut emëror luan rolin e përcaktorit, i cili mund të jetë në rasën rrjedhore njëjës

<sup>16</sup> Shih dhe M. Domi, “Disa çështje të lokucioneve”, *Studime filologjike*, nr. 1, 1985, f. 209-217.

<sup>17</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, “Emërzimi i mbiemrit”, f. 181-184, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.

<sup>18</sup> L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, “Mbiemrat e përngjitur”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009, f. 149-159.

ose shumë, p.sh.: *karrige druri dhe kosh plehrash ose park lojrash* etj. Në togjet e qëndrueshme përcaktorët zakonisht zënë vend pas gjymtyrës së dytë të tij p.sh.: *kopësht fëmijësh i ri, sallatë fshati e freskët, bojë flokësh e kuqe, qumësht lope i trashë* etj., ndërkaq që në togjet e pangulitura (të lira) e ndeshim përcaktorin normalisht pas gjymtyrës së tij të parë. Në gjuhën shqipe ka raste kur ndryshimi i numrit nga njëjës në shumë të elementit të dytë të togut (përcaktorit) formojnë dy njësi me kuptime të ndryshme, p.sh.: *stacion i autobusit dhe stacioni i autobusave*<sup>19</sup>, ku togfjalëshi i parë tregon vendin ku ndalet autobusi gjatë udhëtimit të tij, ndërsa togfjalëshi i dytë tregon stacionin e përgjithshëm të autobusave prej nga nisen ose mbyll intinerarin e tyre. Po ashtu, togfjalëshi i qëndrueshëm nga pikëpamja semantike ka raste që mund të krijojë sinonimi me një fjalë të vetme, p.sh.: emri i babës (atësi), emri i nënës (mëmësi), gjellë spinaqi me oriz (burani) etj., ndërsa morfologjikisht elementet e tij përbërëse kanë kategorinë gramatikore të emrit dhe marrin mbaresat përkatëse, p.sh.: *çertifikatë lindje, vendngjarje, vendlindje, dyqan veshmbathjesh* etj.

C. Në qoftë se shqyrtojmë disa shembuj të togfjalëshave të qëndrueshëm që përdorim dendur në ligjërimitin e përditshëm, si: *sallatë fshati, supë shtëpie, çaj mali, syze dielli, kapse flokësh, bukë lepurushi, bukë misri, tru peshk, zemër flori, këmbëz ure, sy shqiponj, kokërr gruri* (shembujt janë të pafund), midis tyre evidentojmë dy grupime. Në grupimin e parë: *sallatë fshati, supë shtëpie, çaj mali, rrugë qyteti, syze dielli, kapse flokësh, bukë misri, kokërr gruri* etj., togfjalëshat përmbajnë dy fjalë që shënojnë dy koncepte të lidhura ndërmjet tyre: për realien (*sallatë, supë, çaj, rrugë, syze ...*) dhe për përkatësinë, rrethanën ose cilësinë e tyre (fshati, shtëpie, mali, qyteti, dielli ...). Këta togfjalësha njihen me emërtimin togfjalësha të qëndrueshëm (jo frazeologjikë) dhe janë të pafund në numër, pasi me njësinë *kokërr* si *kokërr gruri* krijohet një numër i madh togjesh emërore, si *kokërr misri, kokërr molle ...* etj. Në klasifikimin e dytë përfshihen togfjalësha të qëndrueshëm që nuk jepen me

---

<sup>19</sup> I. Arapi, *Togfjalëshat e qëndrueshëm ..., vep. cit.*

kuptimin e drejtpërdrejtë (në rrafshin e parë kuptimor), por të kristalizuar me kuptimin e figurshëm (në rrafshin e dytë) me përdorim metaforik, ku njësitë *sy shqiponjë*, *bukë lepurushi*, *tru peshk* etj., nuk janë formuar për të shënur realin (*sy*, *bukë*, *tru*) dhe cilësinë e tyre (shqiponjë, lepurushi, peshk), por për të emërtuar një cilësi të vetme sipas një tipari që zotëron<sup>20</sup>, p.sh.: *sy shqiponjë* në FGJSSh '80 “njeri tim, syapatrembur e krenar”, *sy pishë* në FGJSSh '80 togfjalësh homonim me njësinë paraprake “ka shikim të mprehtë, është syhapët, guximtar, krenar”; *tru peshk* “i trashë, nuk kupton”; *bukë lepurushi* “bukë e bardhë, e butë si lëkura e lepurushit” tregon cilësi të lart; *këmbë ure* “i nështruar”, *rrush vajguri* në FGJSSh '80 “lloj rryshi i zi që piqet vonë dhe ka erë si të vajgurit”; *qumësht gëlqere* në FGJSSh '80 “lëng i bardhë që del kur treten disa lëndë në ujë” etj. Këta togfjalësha njihen me emrin *togfjalësha të qëndrueshëm (frazeologjikë)*, kategori e trajtuar gjerë nga prof. J. Thomai. Si togfjalëshi i qëndrueshëm jofrazeologjik i ligjërimit të përgjithshëm, po ashtu dhe togfjalëshi i qëndrueshëm terminologjik / frazeoterm përbën një njësi konceptore-gjuhësore brenda një sistemi të caktuar të një ose disa fushave semantike apo terminologjike, pra uniteti na shfaqet i dyfishtë. Ja lidhja ndërmjet dy gjymtyrëve *vaj* dhe *ulliri* për të shprehur objektin e caktuar (në komunikimin e përgjithshëm), si dhe kombinimin e njësisë *vaj* me gjithë njësitë leksikore që ndeshim në përditshmëri, por njëkohësisht edhe në fusha më të specializuara të dijes, p.sh.: *vaj misri* / *vaj luledielli* / *kikiriku* / *bajamesh* / *peshku* / *palme* / *liri* / *kokosi* (ligj. përgjith.)<sup>21</sup>; *vaj vitrioli* (kim.); *vaj transformatori* (mek. dhe kim.); *vaj mineral* (kim.) etj. Kështu, në morinë e togfjalëshave të qëndrueshëm mund të shquajmë togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) nga ata terminologjikë ose të emëruar ndryshe frazeoterma. Në disa raste togfjalëshat e qëndrueshëm (jo

<sup>20</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, f. 207.

<sup>21</sup> Shih për më tepër *Fjalor i termave bazë të kimisë* (shq.-ang., ang.-shq.), Dh. Haxhimihali, D. Topi, E. Andoni, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Sesioni i shkencave natyrore dhe teknike, Tiranë, 2019, f. 216-217.

frazeologjikë) janë bërë burim për krijimin e togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë / frazeotermat, pikërisht me vendosjen e lidhjes së figurshme ndërmjet elementeve të tij përbërëse, të afërta me njësitë frazeologjike. Këto lidhje prof. Duro i quan me **motivim zero**, pasi shënojnë ngjyresa stilistike-emocionale (lidhjen jo të drejtpërdrejtë me objektin) dhe janë të papëlqyeshme për terminologjinë, si p.sh.: *bisht qeni* (detal. mek.); *çelës anglez* (mek.); *gjuhë lope* (bot.); *gojë ujku* (bot.) etj. Veçanërisht me togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë), sikurse pohon M. Domi, janë formuar emërtime të mjaft luleve e bimëve, të ndonjë sendi e nocioni tjetër p.sh.: *lule dhensh*, *bar ethesh*, *bar delli*, (*sygjarpër*, *rrush qeni*, *pendkaposh*)<sup>22</sup> etj. Pohimi i prof. M. Domi mbetet i vlefshëm për atë kohë, ndërkaq në kohët e sotme, kjo mënyrë fjalëformuese ka zgjeruar funksionin e saj, jo vetëm për formimin e emrave të bimëve e luleve, por është mjeti kryesor për të shprehur nocionet e reja ose rikuptimësimin e tyre në komunikimin e përditshëm.

**D.** Në “Gramatikën e gjuhës së shqipe (2002)” ndryshe nga togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) trajtohen në mënyrë të plotë lokucionet si një grup fjalësh me lidhje të qëndrueshme midis tyre, me vlerën e një pjese të ligjëratës, veçanërisht për pjesët e pandryshueshme të saj (si ndajfolja, parafjala, pjesëza e pasthirrma, por gjithashtu edhe tek folja), që si kuptimisht, ashtu edhe gramatikisht janë të barasvlershme me një fjalë të vetme.<sup>23</sup> Togfjalëshat e qëndrueshëm ashtu sikurse

---

<sup>22</sup> I pasur me këto lloj togfjalëshash terminologjikë (frazeologjikë) me burim nga togjet e qëndrueshme të ligjërimit të përgjithshëm është *Fjalori shpjegues i termave të botanikës* me autor J. Vangjeli, F. Krasniqi, E. Kongjika, L. Susuri, Akademia e Shkencave të Shqipërisë & Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Tiranë – Prishtinë, 2012.

<sup>23</sup> Shembuj të disa lokucioneve marrë nga GGJSh 2002, f. 41: *Në tym* – *Mos rri këtu në tym* ose lokucion homonim *Ai fliste në tym* (kot më kot); *në vend* (edhe lok. homonim = në këmbë), *për punë* (edhe lok. homonim = për shkak) *për lokucione parafjalore* (parafjalë + emër); *copë e çikë*, *javë për javë* për lok. ndajfoljore. Lokucion që shërben si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës (ndajfolje, parafjalë etj.) d.m.th.

lokucionet janë njësi semantiko-leksikore, veçse togfjalëshat e qëndrueshëm, sikurse pohon prof. M. Domi, paraqesin një kohezion semantik e strukturor më të madh, përbëjnë një njësi më të kristalizuar. Normalisht, vazhdon ai, *në lidhje me kompozitat ky kohezion nuk arrin në shkallën e kohezionit të fjalëve të përbëra, qofshin këto të formuara prej elementesh të shkruara ose të ndara me vizë lidhëse ... Ai vijon ... çdo lokucion është një togfjalësh i qëndrueshëm dhe shpesh edhe njësi e shprehje frazeologjike, po jo çdo njësi frazeologjike, as çdo togfjalësh i qëndrueshëm është lokucion. Çështjen e shqyrtimit dhe identifikimit të togfjalëshave të qëndrueshëm dhe përcaktimi i vendit që i takon në morfologji e fjalëformim, prof. Domi e propozon si një problem e detyrë që kërkon zgjidhje. Pra, nga sa thamë, mbështetur në pohimin e prof. M. Domit: *Duhet pranuar qenia e lokucioneve emërore, mbiemërore, përemërore, numërore, pse kemi togje fjalësh të qëndrueshme që shënojnë një nocion të vetëm e funksionojnë si emra, mbiemra, numërorë, përemra. Ata duhen shqyrtuar e identifikuar, duke zënë vendin që i takon në morfologji e në fjalëformim.*<sup>24</sup>*

Togfjalëshat e qëndrueshëm të shqipes në krahasim me njësi të njëjta ose të përafërta të gjuhëve të huaja korrespondojnë në gjuhën italiane me emrat me parafjalë, p.sh.: *luna di miele* për *muaji i mjaltit*; në gjuhën gjermane me kompozitat p.sh. *grup nxënësish* për fjalën e përbërë *Schulergruppe*; por mundësi më të madhe krahasimi të togjeve të qëndrueshme të shqipes na e jep gjuha angleze, si një gjuhë që dallohet për natyrën analitike p.sh.: *black star – ylli i zi*; *homework – detyrë shtëpie*; *black hole – vrimë e zezë* etj., temë që mbetet të trajtohet hollësisht në një nga punimet e ardhshme.

---

funksionon si një fjalë e vetme. Tashmë, veçanërisht nga studimet e kohëve të fundit, kjo ndarje është më se e qartë.

<sup>24</sup> M. Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1985, f. 209-217.

### **Si përfundim:**

Në lidhje me emërtimet e togjeve të ngurtësuara me vlerë emërore dhe mbiemërore, duke u mbështetur në mendimet / vlerësimet e dijetarëve gjuhëtarë, parapëlqehen emërtimet “togfjalësh i qëndrueshëm” për togjet në përdorimin e përgjithshëm dhe “frazeoterm/a” në përdorimet e gjuhëve speciale. Togjet e qëndrueshme emërore si një nga mjetet dhe mënyrat fjalëformuese analitike të pasurimit të shqipes me fjalë të reja përfshihen në kategorinë e madhe të frazeologjisë, por njëkohësisht kanë dallimet e tyre dhe duhet të zënë vendin e posaçëm, atë që ato meritojnë:

1. në trajtimet normative leksikologjike / fjalëformuese duke u përfshirë në tekstet gramatikore mësimore universitare dhe pasuniversitare.

2. në fjalorët shpjegues, veçanërisht në fjalorin e madh të shqipes, si dhe në ata dygjuhësh ku togjet e qëndrueshme të ligjërimit të përgjithshëm / frazeotermat të jepen si lema më vete, njësoj si fjalët atëherë kur nevojitet, p.sh.: *yll deti, punëdore (me përngjitje)* të përfshihen edhe njësitë, si p.sh.: *rrënjë katrore, dhomë gjumi, detyrë shtëpie, orë pune* etj., me synimin për përfshirjen pikërisht të atyre togjeve të ngurtësuara që shënojnë përdorim real dhe domosdoshmëri të objektit dhe funksionit të tij në jetën e përditshme. Ky propozim mbështetet në dosmosdoshmërinë e analizimit të atyre togjeve të qëndrueshme me vlerë shënuese të barasvlershme me fjalën, duke i veçuar ato nga karakteristikat e përgjithshme të togjeve të qëndrueshme, duke qenë në përgjithësi njësi gjuhësore të gjysmënjësuar, pra jo njësi shënuese plotësisht të mëvetësuara sikurse janë fjalët.

Gjithashtu, nga sa analizuam, del e domosdoshme studimi dhe pasqyrimi dallues midis togfjalëshave të qëndrueshëm të gjuhës së përgjithshme në përqsaje me togfjalëshat frazeologjikë, togfjalëshat terminologjikë, me togfjalëshat e lirë (si të gjuhës së përgjithshme, ashtu edhe ata terminologjikë), si dhe me nomenklaturat e ndryshme. Trajtimi i togfjalëshave të qëndrueshëm si pjesë e rëndësishme në disiplinën e frazeologjisë / fjalëformimit qartëson fytyrën e togjeve të

ngurtësuar sipas një rregulli për struktura të njëjta, në mënyrë që të mos përdoren herë me vizë ndarëse në mes, herë si të përngjitura dhe herë si kompozita, edhe atëherë kur ato janë të formësuar me strukturën e togfjalëshit të qëndrueshëm, p.sh.: *lule dielli, vaj guri, panxhar sheqeri, punë dore, gur kali* (togfjalështa) dhe jo emra të përngjitur *luledielli, vajguri, panxharsheqeri, punëdore, gurkali*<sup>25</sup> sikurse është për *luledele, lulalakër* etj.

## BIBLIOGRAFI

- Arap, I. *Togfjalëshat e qëndrueshëm si mënyrë për formimin e emrave në gjuhën shqipe në gjuhën shqipe*, [https://www.academia.edu/37965916/Togfjal%C3%ABshat\\_e\\_q%C3%ABndruesh%C3%ABm\\_si\\_m%C3%ABn\\_yr%C3%ABp%C3%ABr\\_formimin\\_e\\_emrave\\_n%C3%ABgjuh%C3%ABn\\_shqipe](https://www.academia.edu/37965916/Togfjal%C3%ABshat_e_q%C3%ABndruesh%C3%ABm_si_m%C3%ABn_yr%C3%ABp%C3%ABr_formimin_e_emrave_n%C3%ABgjuh%C3%ABn_shqipe)
- Buxheli, L. “Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe”, *Kreu III, Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës të formuara me përngjitje*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009.
- Cipo, K. Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në dy vëllime, 1972 Vëllimi I, f. 63-64.
- Disertacioni i dr. Ciljeta Nikolla “Veçori të frazeotermave në ligjërimet publike të politikanëve shqiptarë dhe të huaj”, 2019.
- Dom, M. *Disa çështje të lokucioneve*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1985, f. 209-217.
- Duro, A. “Terminologjia si sistem” (Gjuhësi), *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, f. 46-47. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980.

<sup>25</sup> L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, “Bashkëlidhja e emrave të përngjitur me njësitë motivuese”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009, f. 127. ... *krahas emrave të përngjitur përdoren si njësi të leksikalizuara dhe togfjalëshat a fjalitë me të cilat ata motivohen ...*

*Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954.

*Gramatika e gjuhës shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.

Haxhimihali, Dh. – Topi, D. – Andoni, E. *Fjalor i termave bazë të kimisë* (shq.-ang., ang.-shq.), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Sesioni i shkencave natyrore dhe teknike, Tiranë, 2019, f. 216-217.

Kostallari, A. *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, “Studime mbi leksikun”, 2, 1972.

Samara, M. *Mbi leksikun politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas Çlirimit*, “Studime mbi leksikun”, 1, 1972.

Thomai, J. “Njësia frazeologjike dhe togfjalëshi i lirë”, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2011.

Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena.

Vangjeli, J. – Krasniqi, F. – Kongjika, E. – Susuri, L. *Fjalori shpjegues i termave të botanikës*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë & Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Tiranë – Prishtinë, 2012.

